| 25. Procedura e ankesës | <p>1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.</p> <p>2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.</p> |
|--------------------------------|---|

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Cmimeve;

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.	Analiza dhe diagnostifikimi organizativ				
2.	Dizenjimi i strukture se re				
3.	Standartizimi i proceseve				
4.	Implementimi				
5.	Monitorimi				
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					

TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga
Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik
“.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën
përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë
personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e
prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti
Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e
prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe
pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara
nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. FUSHA E SHËRBIMIT

Objekti i këtij shërbimi është realizimi i një procesi të plotë konsulence për analizën, riorganizimin dhe mbështetjen e implementimit të strukturës organizative të Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a. (në vijim "UKT" ose "Autoriteti Kontraktor").

Shërbimi duhet të përfshijë ciklin e ndërhyrjes organizative: mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, analizën e dokumentacionit ekzistues dhe studimet e mëparshme, konsultimet me nivelet ekzekutive, identifikimin e paqartësive dhe mbivendosjeve në strukturë, projektimin e strukturës së

synuar, dokumentimin e modelit të ri dhe asistencën teknike gjatë zbatimit. Shërbimi do të mbështetet në dokumentacionin ekzistues dhe informacionin e mbledhur nga strukturat përkatëse të UKT, përfshirë strukturën aktuale, ndarjen e funksioneve, përshkrimet ekzistuese të roleve dhe praktikat aktuale të raportimit e koordinimit. Ky informacion do të shërbejë si bazë për hartimin e rekomandimeve për riorganizimin e strukturës, me fokus qartësimin e përgjegjësi, reduktimin e mbivendosjeve dhe përmirësimin e eficiencës organizative.

Rezultati përfundimtar i shërbimit duhet të jetë një model strukture organizative e qartë, funksionale, e zbatueshme dhe e dokumentuar, e cila mbështet eficiencën operacionale, qartësinë e raportimit, koordinimin ndërmjet njësive dhe menaxhimin më të mirë të burimeve njerëzore, dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit publik.

2. QËLLIMI I SHËRBIMIT

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë UKT në ndërtimin dhe implementimin e një strukture organizative më funksionale, më të qartë dhe më të përshtatur me misionin, shërbimet, kompleksitetin operacional dhe objektivat strategjike të shoqërisë. Qëllimi është:

- të identifikojë mbivendosjet, boshllëqet funksionale, hallkat e panevojshme, varësitë e paqarta dhe pikat e ngadalësimit;
- të projektojë një strukturë që lidh qartë funksionet dhe përgjegjësitë kryesore të njësive me nevojën për shërbim më cilësor ndaj qytetarëve;
- të qartësojë ndarjen e përgjegjësi sipas hierarkisë, linjat e raportimit dhe vendimarrjen organizative në funksion të modelit të ri;
- të reduktojë funksionet e dubluara dhe elementet e strukturës së mbingarkuar, aty ku ato evidentohen nga analiza dhe konsultimet;
- të përgatisë dokumentacion praktik për zbatim dhe të mbështesë drejtorinë përgjegjëse gjatë tranzicionit organizativ.
- të përcaktojë kriteret minimale të kualifikimit (arsim, eksperiencë, kompetenca) për çdo pozicion pune në strukturën e synuar, si bazë për vlerësimin e përputhshmërisë së burimeve njerëzore ekzistuese dhe nevojave të rekrutimit për pozicionet që preken.

3. TË DHËNAT KRYESORE TË PROJEKTIT

UKT ka një strukturë të gjerë organizative, me një kombinim të funksioneve drejtuese, teknike, operacionale, territoriale, tregtare, financiare, ligjore, të shërbimit ndaj klientit dhe funksioneve mbështetëse.

Treguesi	E dhëna paraprake
Numri i njësive/strukturave të listuara	26
Totali i punonjësve sipas strukturës	1,347
Punonjës administratë	566
Punëtorë	781
Fushat kryesore të përfshira	Drejtimit i përgjithshëm, audit, juridik, prokurim, kujdes klienti, shërbime mbështetëse, IT, shitje, ekonomi, taksa, inxhinieri, operacion, prodhim-shpërndarje, njësi Tirana dhe drejtori rajonale

4. PËRSHKRIM I SHKURTËR I SITUATËS EKZISTUESE

UKT është një shoqëri që ofron shërbime publike me ndikim të drejtpërdrejtë në qytetarë, biznese dhe institucione. Aktivitetet e saj lidhen me furnizimin me ujë të pijshëm, administrimin e rrjetit dhe të aseteve teknike, shërbimet e kanalizimeve, monitorimin e cilësisë së ujit, ndërhyrjet në terren,

shërbimin ndaj abonentëve, faturimin, arkëtimin, investimet, prokurimet dhe funksionet mbështetëse.

Natyra kritike e shërbimit publik kërkon një strukturë organizative që të jetë e aftë të mbështesë vazhdimësinë e shërbimit, reagimin e shpejtë ndaj sfidave dhe kërkesave të qytetarëve dhe bizneseve, ndarjen e qartë të përgjegjësi, kontrollin e brendshëm efektiv, bashkëpunimin ndër funksional dhe kulturën e menaxhimit të orientuar drejt performancës dhe të mirës publike

Riorganizimi nuk duhet të kufizohet në ndryshimin formal të organigramës. Ai duhet të trajtojë mënyrën reale të funksionimit të organizatës: funksionet e njësive, rolet, përgjegjësitë, linjat e raportimit, flukset e punës, ndërrarësitë, vendimmarrjen, rrjedhën e informacionit dhe mekanizmat e raportimit. Qëllimi është që struktura e re të mbështesë cilësi më të mirë shërbimi ndaj qytetarëve, të minimizojë rolet dhe funksionet e dubluara dhe të adresojë elementet e strukturës së mbingarkuar, kur këto konfirmohen nga analiza e dokumenteve dhe konsultimet.

II. OBJEKTIVI

Objektivi i shërbimit të kërkuar është mbështetja e UKT në analizimin e strukturës ekzistuese, rivlerësimin e strukturës së synuar dhe hartimin e një modeli organizativ të qartë, praktik dhe të zbatueshëm.

- Të kryhet analizë e strukturës aktuale, funksioneve, roleve, numrit të punonjësve dhe linjave të raportimit.
- Të vlerësohet në mënyrë të përgjithshme përshtatshmëria e strukturës aktuale me nevojat e shërbimit dhe funksionet kryesore organizative, duke u mbështetur në analizë të proceseve operative.
- Të identifikohen oportunitetet organizative që ndikojnë në cilësinë e shërbimit, eficiencën operacionale, qartësinë e raportimit dhe koordinimin ndërmjet njësive.
- Të projektohet struktura e synuar organizative, me nivele të qarta hierarkike, funksione të përcaktuara të njësive dhe linja raportimi të kuptueshme.
- Të përdoren përshkrimet ekzistuese të roleve, dokumentet e brendshme dhe të dhënat e stafit si burim informacioni për të kuptuar ndarjen aktuale të përgjegjësi dhe për të mbështetur propozimin e strukturës së re.
- Të hartohet plani i implementimit të strukturës së re, përfshirë tranzicionin, komunikimin, monitorimin dhe asistencën teknike në aplikim.
- Të sigurohet dokumentacioni i nevojshëm të strukturat e brendshme të UKT, që mbështet aplikimin në vazhdimësi të modelit të ri organizativ pas përfundimit të kontratës.

Çdo rekomandim duhet të jetë i lidhur me evidencën e mbledhur gjatë projektit dhe të jetë i realizueshëm në kushtet konkrete të Autoritetit Kontraktor. Konsulenti duhet të shmangë propozimet gjenerike dhe të ofrojë një model sipas standarteve të larta administrative që reflekton natyrën e UKT si shoqëri shërbimi publik me kompleksitet teknik, operacional, territorial dhe administrativ.

III. TË DHËNAT PËR SHËRBIMIN

Për hartimin e analizës dhe të modelit të ri organizativ, konsulenti duhet të përdorë minimalisht kategoritë e mëposhtme të të dhënave, sipas disponueshmërisë dhe miratimit të Autoritetit Kontraktor:

- Organigrama aktuale, ndryshimet e miratuara dhe çdo variant pune i strukturës së UKT në 5 (pesë) vitet e fundit.
- Lista e njësive, pozicioneve dhe punonjësve, sipas kategorive administratë/punëtorë, vendndodhjes, funksionit dhe nivelit hierarkik.
- Përshkrimet ekzistuese të roleve, rregulloret e brendshme, aktet organizative dhe procedurat kryesore, si burime informacioni për ndarjen aktuale të përgjegjësisë.
- Të dhëna mbi kualifikimin dhe profilin e punonjësve si: arsimi, eksperiencë, certifikimet dhe vjetërsia për çdo pozicion pune, të nevojshme për vlerësimin e përputhshmërisë së burimeve njerëzore ekzistuese me strukturën e synuar dhe identifikimin e nevojave për trajnim apo rekrutim për profilet që do të preken.
- Të dhëna mbi flukset kryesore të punës dhe ndërveprimet ndërmjet njësive, përfshirë furnizim/prodhim/shpërndarje uji, mirëmbajtje rrjeti, kanalizime, avari, cilësi uji, shërbim klienti, faturim, arkëtim, investime, prokurim, financë, juridik, HR, IT dhe kontroll.
- Legjislacioni në fuqi për organizimin e funksionit administrativ të sh.a
- Të dhëna mbi qarkullimin e stafit (turnover) — largime vullnetare dhe të pavullnetare, rekrutime, pozicione vakante dhe kohëzgjatja mesatare e mbushjes së tyre, të ndara sipas njësisë/drejtorie dhe periudhës, si tregues i stabilitetit organizativ dhe zonave me problematikë të vazhdueshme të burimeve njerëzore.
- Raporte performance, KPI, raporte auditimi/risku dhe dokumente të tjera që ndikojnë në analizën organizative.
- Të dhëna mbi fluksin e vendimmarrjes, miratimet, ndërfaqet ndërmjet njësive, komunikimin e brendshëm dhe mekanizmat aktualë të raportimit.
- Informacion mbi prioritetet strategjike dhe sfidat operative që duhet të adresohen nëpërmjet objektit të këtij shërbimi.

Konsulenti duhet të kryejë validimin e të dhënave fillestare dhe të evidentojë çdo mospërputhje, paqartësi apo mungesë informacioni që mund të ndikojë në cilësinë e analizës dhe të strukturës së propozuar.

IV. KËRKESAT QË DUHET TË ZGJIDHË SHËRBIMI

Në mbështetje të strukturës ekzistuese dhe objektivave të Autoritetit Kontraktor, konsulenti duhet të hartojë një zgjidhje organizative që adreson minimalisht kërkesat e mëposhtme:

- qartësimin e roleve dhe linjave të raportimit;
- reduktimin e mbivendosjeve, fragmentimit të funksioneve dhe roleve të dubluara;
- përcaktimin e kriterëve të kualifikimit (arsim, eksperiencë,) për çdo pozicion pune në strukturën e synuar — me synim që struktura të lidhet me pozicionet e punës që do të preken.
- rishikimin e elementeve të strukturës ,aty ku analiza tregon se ato nuk i shërbejnë eficiencës apo cilësisë së shërbimit;
- forcimin e koordinimit ndërmjet funksioneve teknike, operacionale, territoriale, tregtare dhe mbështetëse;
- balancimin e hapësirës së veprimit dhe niveleve hierarkike, në mënyrë që vendimmarrja të jetë më e qartë dhe më e shpejtë;
- ndarjen e duhur të funksioneve të kontrollit, zbatimit, planifikimit, monitorimit dhe raportimit;
- hartimin e dokumentacionit organizativ në format të unifikuar dhe të përdorshëm nga strukturat përgjegjëse;

- mbështetjen e menaxhimit të ndryshimit, komunikimit të brendshëm dhe orientimit të drejtuesve gjatë zbatimit.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KONSULENTIT

Në realizimin e objektivave të këtij shërbimi, konsulenti duhet të organizojë punën në faza të qarta, të lidhura me mënyrën se si do të mbledhet informacioni, do të validohen gjetjet dhe do të hartohet struktura e propozuar. Faza pasardhëse mund të nisë pas diskutimit të produkteve kryesore të fazës paraprake ose paralelisht, nëse palët bien dakord dhe kjo nuk cenon cilësinë e analizës.

Faza	Fokusi	Aktivitetet minimale	Produktet kryesore
Faza I	Analiza e dokumentacionit ekzistues	Shqyrtim i strukturës aktuale, përshkrimeve ekzistuese të roleve, ndarjes së përgjegjësisë, të dhënave të stafit dhe çdo dokumenti tjetër relevant organizativ.	Raport i analizës dokumentare dhe gjetje paraprake.
Faza II	Konsultime me vendimarrësit	Takime pune me vendimarrësit për të diskutuar gjetjet e analizës, sfidat aktuale dhe perceptimet mbi funksionimin e strukturës ekzistuese.	Përmbledhje e konsultimeve me drejtuesit dhe prioritetet e riorganizimit.
Faza III	Projekt-struktura paraprake dhe alternativat	Hartim i alternativave; përzgjedhje e modelit të rekomanduar.	Alternativa të strukturës dhe strukturë target në draft
Faza IV	Struktura përfundimtare dhe dokumentacioni	Hartim i strukturës përfundimtare, organigramë, matricë përgjegjësisë dhe plan implementimi.	Struktura e propozuar, plan implementimi dhe dokumente zbatimi.
Faza V	Finalizimi, mbështetja e implementimit dhe transferimi i njohurive	Finalizim i dokumenteve, orientim për strukturat zbatuese, asistencë teknike, raportim i ecurisë dhe transferim i instrumenteve.	Raport final, manual implementimi dhe paketë materialesh editueshme.

Produktet/deliverables të detyrueshme

Kodi	Produkti	Përmbajtja minimale	Formati
------	----------	---------------------	---------

D1	Raport diagnostik organizativ	Analiza e strukturës aktuale, ndarjes së përgjegjëse dhe gjetjeve paraprake.	Word/PDF
D2	Përmbledhje e konsultimeve drejtuesit e lartë	Prioritetet institucionale, sfidat kryesore, perceptimet mbi strukturën ekzistuese dhe kriteret orientuese të riorganizimit.	Word/PDF/PPT
D3	Draft propozimi i strukturës së synuar	Parashtrimi i draft propozimit me avantazhet, kufizimet, ndikimin në staf, ndikimin në cilësinë e shërbimit dhe realizueshmëri.	PPT/Word/PDF
D4	Struktura organizative e propozuar	Organigramë makro/mikro, linja raportimi, funksione kryesore të njësive, hapësirë e mbikëqyrjes dhe argumentim teknik.	PPT/format editues/PDF
D5	Matrica e përgjegjëse dhe raportimit	Ndarja e përgjegjëse, autoritetit, konsultimit, koordinimit dhe raportimit ndërmjet njësive.	Excel/Word/PDF
D6	Plan implementimi dhe tranzicioni	Hapat e zbatimit, afatet, përgjegjësit, risqet, komunikimi, monitorimi dhe masat korrigjuese.	Excel/Word/PDF
D7	Plan komunikimi	Plan për komunikimin e brendshëm mbi implementimin e strukture se re	Word/PPT/PDF
D8	Manual implementimi	Materiale praktike për strukturën që do të menaxhojë implementimin, përfshirë udhëzime, hapa zbatimi dhe formate ndjekjeje.	Word/PDF
D9	Raport final dhe dorëzim	Përmbledhje e punës, rezultatet, çështjet e mbetura, rekomandimet dhe materialet e editueshme.	Word/PDF + materiale editueshme

Menaxhimi, raportimi dhe komunikimi

Për zbatimin efektiv të projektit, Autoriteti Kontraktor dhe konsulenti duhet të krijojnë mekanizma të qartë menaxhimi të procesit dhe raportimi.

- Konsulenti duhet të dorëzojë raport progresi të paktën një herë në muaj ose sipas grafikut të miratuar.
- Çdo produkt duhet të dorëzohet në version draft për komente dhe më pas në version final pas reflektimit të komenteve të pranuar me shkrim.
- Çështjet që kërkojnë vendimmarrje nga Autoriteti Kontraktor duhet të identifikohen qartë në raportet e progresit.

VI. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT

Kohëzgjatja e rekomanduar për realizimin e shërbimit është 5 (pesë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Afati përfundimtar do të përcaktohet në kontratë, në varësi të fondit limit, kompleksitetit, numrit të njësive që do të përfshihen dhe disponueshmërisë së të dhënave nga Autoriteti Kontraktor.

Nr.	Faza	Aktivitetet kryesore	Dorëzimet	Kohëzgjatja
1	Muaji 1 / Faza I	Analiza e dokumentacionit ekzistues, strukturës aktuale, përshkrimeve ekzistuese të roleve, ndarjes së përgjegjësisë dhe të dhënave të stafit.	D1	Brenda muajit të parë nga nënshkrimi i kontratës
2	Muaji 2 / Faza II	Konsultime dhe takime pune me drejtuesit e lartë për prioritetet, sfidat dhe drejtimin e riorganizimit.	D2	Brenda muajit të dytë nga nënshkrimi i kontratës
3	Muaji 4 / Faza III	Fokus-grupe dhe takime me nivelet ekzekutive; përgatitja e diagnozës organizative dhe rekomandimeve paraprahe.	D3	Brenda muajit të katërt nga nënshkrimi i kontratës
4	Muaji 4 / Faza IV	Hartimi i alternativave, strukturës së propozuar, matricës së përgjegjësisë dhe planit të implementimit/komunikimit.	D4, D5, D6, D7	Brenda muajit të katërt nga nënshkrimi i kontratës
5	Muaji 5 / Faza V	Finalizimi i dokumenteve, mbështetja e implementimit, manuali i zbatimit, raporti final dhe dorëzimi i materialeve.	D8, D9	Brenda muajit të pestë nga nënshkrimi i kontratës

Në afate duhet të përfshihet koha për komentet e Autoritetit Kontraktor dhe korrigjimet nga konsulenti. Çdo produkt final duhet të dorëzohet në format të editueshëm dhe PDF, i shoqëruar me listë inventari të dokumenteve të dorëzuara.

Për çdo produkt të dorëzuar, procedura e shqyrtimit do të jetë si më poshtë:

- Konsulenti dorëzon produktin përkatës sipas afateve të përcaktuara për secilën fazë të projektit.
- Autoriteti Kontraktor shqyrton produktin dhe paraqet komentet, vërejtjet ose kërkesat për plotësim **brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike** nga data e dorëzimit.
- Konsulenti është i detyruar të reflektojë komentet e Autoritetit Kontraktor dhe të ridorëzojë versionin e rishikuar **brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike** nga marrja e komenteve.
- Autoriteti Kontraktor, pas verifikimit të versionit të rishikuar, miraton produktin përkatës ose kërkon plotësime të tjera, nëse është e nevojshme, **brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike**.
- Procesi i mësipërm do të zbatohet për secilin prej produkteve të parashikuara në Fazat I–V.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: II. OBJEKTIVI

Objekti i shërbimit të kërkuar është mbështetja e UKT në analizimin e strukturës ekzistuese, rivlerësimin e strukturës së synuar dhe hartimin e një modeli organizativ të qartë, praktik dhe të zbatueshëm.

- Të kryhet analizë e strukturës aktuale, funksioneve, roleve, numrit të punonjësve dhe linjave të raportimit.
- Të vlerësohet në mënyrë të përgjithshme përshtatshmëria e strukturës aktuale me nevojat e shërbimit dhe funksionet kryesore organizative, duke u mbështetur në analizë të proceseve operative.
- Të identifikohen oportunitetet organizative që ndikojnë në cilësinë e shërbimit, eficiencën operacionale, qartësinë e raportimit dhe koordinimin ndërmjet njësive.
- Të projektohet struktura e synuar organizative, me nivele të qarta hierarkike, funksione të përcaktuara të njësive dhe linja raportimi të kuptueshme.
- Të përdoren përshkrimet ekzistuese të roleve, dokumentet e brendshme dhe të dhënat e stafit si burim informacioni për të kuptuar ndarjen aktuale të përgjegjësive dhe për të mbështetur propozimin e strukturës së re.
- Të hartohet plani i implementimit të strukturës së re, përfshirë tranzicionin, komunikimin, monitorimin dhe asistencën teknike në aplikim.
- Të sigurohet dokumentacioni i nevojshëm të strukturat e brendshme të UKT, që mbështet aplikimin në vazhdimësi të modelit të ri organizativ pas përfundimit të kontratës.

Çdo rekomandim duhet të jetë i lidhur me evidencën e mbledhur gjatë projektit dhe të jetë i realizueshëm në kushtet konkrete të Autoritetit Kontraktor. Konsulenti duhet të shmangë propozimet gjenerike dhe të ofrojë një model sipas standarteve të larta administrative që reflekton natyrën e UKT si shoqëri shërbimi publik me kompleksitet teknik, operacional, territorial dhe administrativ.

Detyrat: V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KONSULENTIT

Në realizimin e objektivave të këtij shërbimi, konsulenti duhet të organizojë punën në faza të qarta, të lidhura me mënyrën se si do të mblidhet informacioni, do të validohen gjetjet dhe do të hartohet struktura e propozuar. Faza pasardhëse mund të nisë pas diskutimit të produkteve kryesore të fazës paraprake ose paralelisht, nëse palët bien dakord dhe kjo nuk cenon cilësinë e analizës.

Faza	Fokusi	Aktivitetet minimale	Produktet kryesore
Faza I	Analiza e dokumentacionit ekzistues	Shqyrtim i strukturës aktuale, përshkrimeve ekzistuese të roleve, ndarjes së përgjegjësive, të dhënave të stafit dhe çdo dokumenti tjetër relevant organizativ.	Raport i analizës dokumentare dhe gjetje paraprake.

Faza II	Konsultime me vendimmarresit	Takime pune me vendimmarrësit për të diskutuar gjetjet e analizës, sfidat aktuale dhe perceptimet mbi funksionimin e strukturës ekzistuese.	Përmbledhje e konsultimeve me drejtuesit dhe prioritetet e riorganizimit.
Faza III	Projekt-struktura paraprake dhe alternativat	Hartim i alternativave; përzgjedhje e modelit të rekomanduar.	Alternativa të strukturës dhe strukturë target në draft
Faza IV	Struktura përfundimtare dhe dokumentacioni	Hartim i strukturës përfundimtare, organigramë, matricë përgjegjësish dhe plan implementimi.	Struktura e propozuar, plan implementimi dhe dokumente zbatimi.
Faza V	Finalizimi, mbështetja e implementimit dhe transferimi i njohurive	Finalizim i dokumenteve, orientim për strukturat zbatuese, asistencë teknike, raportim i ecurisë dhe transferim i instrumenteve.	Raport final, manual implementimi dhe paketë materiale editueshme.

Shpërndarja: Ukt sh.a

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Ukt sha

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; përkatësisht në vlerën 187.666,66 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë).*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit

kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit se ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të QKB-së, për këstet e maturuara për vitin 2026, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomike, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të deklarojë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Operatori ekonomik duhet gjithashtu të paraqesë dëshmi për realizimin e të paktën 1 kontrate me organizata/kompani/struktura të mëdha komplekse me jo më pak se 100 punonjës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara nga organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të furnizuara.

Ose

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara, shoqëruar me listëpagesën e muajit të fundit ose deklaratë të lëshuar nga organizata/kompani/struktura të mëdha komplekse me jo më pak se 100 punonjës me të cilën është realizuar kontrata ku të specifikohet numri i punonjësve dhe shërbimi i realizuar.

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

Certifikatën ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt marrëveshjes.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht për periudhën Janar 2026 – Qershor 2026 jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, nga të cilët:

- të paktën 3 (tre) konsulentë për kualifikimet e personelit, të certifikuar për përdorimin e matjeve psikometrike për vlerësimin e individëve dhe ekipeve.
- të paktën 1 (një) ekspert të certifikuar në Programimin e Neuro Linguistikës NLP (Neuro Linguistic Programming).

Për të vërtetuar plotësimin e kësaj pikë ofertuesi duhet të paraqesë:

- Certifikatat përkatëse të vlefshme për 3 (tre) konsulentë për kualifikimet e personelit dhe për 1 (një) ekspert NLP.
- Kontratë pune të vlefshme për 3 (tre) konsulentë për kualifikimet e personelit dhe për 1 (një) ekspert NLP.
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të periudhën Janar 2026 – Qershor 2026

